



BASHKIMI I SINDIKATAVE TË PAVARURA TË KOSOVËS  
THE UNION THE INDEPENDENT OF KOSOVO

Nr. fiskal : 600268793

Adresa: Rr. Nëna Terezë Nr. 35 10000 Prishtinë

Tel 038 222-859

Fax. 038 224-649

E mail: [bspk@bspk.org](mailto:bspk@bspk.org)

## Raport reth disa aktiviteteve për Dhjetor 2014 dhe Janar 2015

Në vijim do ta paraqesim disa nga aktivitetet tona, të cilat kanë qenë të ngjeshura pas konstituimit të institucioneve të Republikës së Kosovë.

Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar takime të shumta me udhëheqësit e institucioneve. Qëllimi i takimeve ka qenë njohja me udhëheqësit e rinjë të institucioneve, ku ne shpalosëm rolin e BSPK-së në proceset e shoqërisë Kosovare, aktivitete saj dhe nevojën për bashkëpunim.

- 16.12.2014. Takim me Ministrin e PMS z. Arban Abrashi. Tema: Pagat MPKK-ve, roli i KES-it dhe bashkëpunimi.
- 17.12.2014, Takim me Ministrin e Financave z. Abdullah Hoti. Tema: Buxheti i vitit 2015, pagat MPKK-ve
- 18.12.2014 Takim me Kryeministrin z. Isa Mustafa. Tema: Buxheti 2015, pagat e MPKK-ve.
- 24.12.2014 Takimi me drejtorin e Aeroportit të Prishtinës z. Haldun Firat Kokturk. Tema: Çështjet e punëtorëve dhe draftimi i Kontratës Kolektive në Aeroportin e Prishtinës.
- 26.12.2014 Debat në RTV 21. Tema: Ngritja e pagave dhe MPKK-ve.
- 29.12.2014 Takim me Ministrin e Diasporës z. Valon Murati. Tema: Forcimi i bashkëpunimit me të punësuarit kosovarë në diasporë e që janë edhe anëtar të sindikatave.
- 30.12.2014 Takim në Kuvendin e Kosovës me z. Kadri Veselin. Tema: Njohja me aktivitetet e BSPK-së dhe deponimi i kërkesës që BSPK-ja ta ketë një vend në Parlamentin e Kosovës
- 30.12.2014 Takim me Kryeministrin z. Isa Mustafa me bashkëpunëtorët e tij. Tema: Ngritja e pagave dhe implementimi i MPKK-ve. Për paga Kryeministri na njoftoi se do të rriten sipas rritjes ekonomike, ndërsa për MPKK-ve na siguroi se do të filloj së implementuari prej 1 Janarit të vitit 2015, së pari me pagesën e përvojës së punës 0.5% për vit. Në takim ishin edhe Rrahman Jashari dhe Ymer Ymeri nga SBASHK-u
- 30.12.2014 Konferenca përmbyllëse për media e BSPK-së
- 30.12.2014 Takimi i KES-it.
- 03.01.2015 Debat në RTV 21. Tema: Implementimi i MPKK-ve.
- 07.01.2015 Takimi me Ministrin e Bujqësisë z. Memli Krasniqi. Tema: Bashkëpunimi me BSPK-në.
- 08.01.2015 Takim në Lëvizjen Vetëvendosje. Tema: Bashkëpunimi me BSPK-në.
- 13.01.2015 Takim me Ministrin e KRS-së z. Kujtim Shala. Tema: Bashkëpunimi me BSPK-në, me fokus në Rrjetin e të Rinjëve të BSPK-së. Meqë z. Kujtim Shala është edhe Zv/Kryeministër, biseduam edhe për çështje tjera me rëndësi si: MPKK-ve, pagat, përfaqësimi i sindikalistëve etj.
- 15.01.2015 Takim me Ministren Hikmete Bajrami, ministre e Tregtisë dhe Industrisë. Tema MPKK-ve
- 16.01.2015 Takim me Ministrin z. Bleradn Stavileci ministër i Zhvillimit Ekonomik. Tema: Bashkëpunimi dhe MPKK-ja

Nga të gjitha takime që i kemi pasur e që do ti kemi në të ardhmën, mund të konstatojmë se këto takime janë tejet të rëndësishme, me qëllim që të njihen institucionet se si janë nivelet e organizimit në Kosovë, me kënd

duhet të takohen për tema të caktuara dhe cili është përfaqësimi legjitim. Paraqitjet e shumë përfaqësuesëve sindikal, ku flasin në emër të BSPK-së pa e pyetur të njëjtën fare, duhet të ndalen. Këto po shkaktojnë dëme të shumta, po ndikojnë keq në fuqinë sindikale dhe seriozitetin e tyre. Mjaft më me improvizime dhe interesa individuale. E kemi për obligim të bashkëpunojmë dhe ti avancojmë interesat e sindikatës në përgjithësi dhe antarsisë në veçanti.

Datë, 14.01.2015

Raportine përpiloi

Prishtinë

Alush Sejdiu, Nënkrjetar i BSPK-së